REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Nr.4 regjistri, datë 6./8.1.2016.
Nr.4 vendimi, datë 18.1.2016.

# VENDIM
NË
"EMËR TË REPUBLIKËS"

Unë Ahmet JANGULLI/ GJYQTAR në gjykatën administrative të shkallës së parë Shkodër, në Shkodër në datën **18.1.2016**, shqyrtova në seancë përgatitore çështjen e veçantë administrative nr.4 akti/ që i përket :

**Kërkues :**

Federik Derza i biri i Preles dhe i Luçes i datl.22.5.1962, banues në lagjen "Ndoc Mazi", rruga "Dragushej", të bashkisë Shkodër.

**P i Tretë :**

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.

Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

**Objekti :**

Rivendosje ne afat te se drejtes per kundershtimin e :
1. Njoftim kerkese per pagimin e te detyrimeve tstimore Nr. 8825/12 dt. 21.10.2010 te DRT Shkoder, si dhe vendimit nr. 20581/2Prot. dt 10.01.2011 te Dr.Apelimit Tatimor Tirane.
2. Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore nr. 1596 dt. 28.02.2012, njoftimi I fundit per detyrimet tatimore nr. 3756/44 dt. 10.05.2012 te DRT Shkoder, si dhe Vendimin nr. 11697/1Prot dt 05.06.2012 te Dr.Apelimit Tatimor Tirane.
3. Njoftim vleresimi nr. 4168Prot. dt 16.05.2011 te DRT Shkoder , si dhe vendimit nr. 14726/1Prot. dt 18.08.2001 te dr.Apelimit Tatimor Tirane.

**B. Ligjore :**

Nenet 7, 11, 15 të ligji 49/2012 'Per organzimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"; Ligji 9920 datë 19.5.2008 "Per procedurat tatimore në Republiken e Shqipërisë", me ndryshime, Udhezim i Ministrisë së Financave nr. 24 date 02.09.2008 , me ndryshime; Ligji nr. 8485

datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative; të Republikës së Shqipërisë", neneve 152, 153 e 154 të K. Pr.Civile.

Gjatë gjykimit, në mungesë të palëve, ku pala kërkuese ka paraqitur një kërkesë me shkrim për/ *heqje dorë nga gjykimi*, e si shqyrtova aktet shkresore në tërësi.

## KONSTATOVA

I.

1. Se, pala kërkuese ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesë duke pretenduar sipas objektit.

II. Rrethanat e faktit :

2. Palët për të cilat rrjedhin të drejta e detyrime, me njeri tjetrin, janë në një konflikt, për veprimet administrative të kryera gjatë mbajtjes së aktit dhe gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ.

3. **Nëpërmjet kancelarisë**, pala kërkuese ka paraqitur një kërkesë me shkrim/ për heqje dorë nga gjykimi i kërkesës.

4. Në rrethanat e mësipërme, çështja ka kaluar për veprime përgatitore, pa i thirrur palët për t'i dëgjuar.

**III. Vlerësimi i gjyqtarit :**

5. Në këto rrethana e çmova se, duhet vendosur pushimi i gjykimit të çështjes.

Sa sipër provohet me aktet shkresore dhe gjithë dokumentacioni në dosje.

## PËR KËTO ARSYE

**Në bazë të nenit 158 gërma a § 1 e 9/ për nenin 299 gërma b)/ për nenin 201 § 1 të k.pr.civile, dhe nenit 39 pika 3 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar.**

## V E N D O S A

Pushimin e gjykimit në çështjen e veçantë administrative nr.4 akti, datë **8.1.2016**, që është ngritur nga pala kërkuese Federik Derza, *për shkakun se hoqi dorë nga gjykimi.*

Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen *palës kërkuese* Federik Derza.

Kundër këtij vendimi lejohet *ankim i veçantë, në gjykatën administrative të apelit Tiranë.*

U shpall në Shkodër *me 18 janar 2016.*

**GJYQTAR**
Ahmet JANGULLI

Shpenzime gjyqësore:

| | |
|---|---|
| Akte – Letër | 50 lekë, |
| Shuma | 50 lekë. |

Sekretare
Entela HASMUJAJ

**VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË**

**SOT ME DATË 16.02.2016**

**KANCELARE**

**BLERTA NURJA**